



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:230647

Datë: 23.08.2024

Numri i dokumentit: 06081081

**AC-I-23-0098**

***Në ankesën e***

***Paditësi***

**S Gj**

**kundër**

***E paditura/Ankuesja***

**N.SH" NGLB-Kosova"** (në likuidim) të cilën e përfaqëson Agjencia Kosovare e Privatizimit, Rr. "Dritan Hoxha", nr. 55, Lakërishtë, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj dhe Hasim Sogojeva gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të paraqitur kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-13-0850 të datës 24 janar 2023, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 23 gusht 2024, lëshon këtë:

## **A K T G J Y K I M**

- 1. Ankesa e paditurës refuzohet si e pabazuar.**
- 2. Vërtetohet Aktgjykimi Shkallës së I-rë i DHPGJS-së, C-IV-13-0850 i datës 24 janar 2023.**
- 3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

## **Rrethanat procedurale dhe faktike**

Më 10 qershor 2013 , paditësi ish punëtor i NSH "NGLB-Kosova" ka ushtruar ankesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovë (më tej "Dhoma e Posaçme") kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit (më tutje AL) nr. PRZ029-0243, të datës 30 maj 2013, me të cilin ka kërkuar kompensimin për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, në shumë prej 540.00 €. Në vendimin e kundërshtuar, ishte refuzuar kërkesa e ankuesit për dëmshpërblim të ndërprerjes së parakohshme të kontratës së punës. Ankuesi ka theksuar se kishte punuar në NSH "NGLB-Kosova", nga 23 maj 1988 deri më 24 shkurt 2005, respektivisht 16 vite dhe për këtë ka gëzon të drejtën e 20%-shit. Si dëmshmi ka bashkangjitur librezën e punës dhe njoftimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës ku statusi i tij si punëtorë i NSH-së është konfirmuar në 24 shkurt 2005, si datë e privatizimit të NSH-së.

Me 30 janar 2020, e paditura AKP-ja ka parashtuar mbrojtje në ankesë, në të cilën pohoi se AL-ja ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore janë zbatuar saktësisht. Po ashtu AKP-ja pohoi se paditësi në momentin e privatizimit 24 shkurt 2005 nuk rezulton në listën e pagave të NSH-së në 12 muajt e fundit nuk punonte për NSH-në marrëdhënia e punës nuk i është ndërprerë, si pasojë e një veprimi të AKP-së, për këtë arsye paditësi nuk gëzon të drejtën të përfitojë dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës sepse, ai nuk i përmbush kushtet ligjore të parapara nga neni 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034.Mbrojtjes i ka bashkangjitur listën e pagave të NSH-së.

Me 24 janar 2023, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-13-0850, e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar ankesën e paditësit, e ka ndryshuar Vendimin Autoritetit të Likuidimit të AKP-së PRZ029-0243, të datës 30 maj 2013, dhe e ka Obliguar të paditurën ti paguaj paditësit S Gj në emër të dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës, shumë prej 486.00 € ndërsa, pjesa tjetër e kërkesës përtej shumës së aprovuar, është refuzuar si e pa bazuar. Shumat e aprovuar si në pikën 2 të dispozitivit do të përmbushen në pajtim të prioritetit sipas kategorisë së përcaktuar të kërkesave dhe interesave në procedurën e likuidimit.

Shkalla e parë në arsyetimin e Aktgjykimit ka konstatuar se Ligji në fuqi :Ligji për Ndërmarrjet (77/88) hyri në fuqi më 01.01.1989 dhe është ligj në fuqi në Kosovë. Ligji për Ndërmarrjet i shfuqizon vetëm ato dispozita të Ligjit për Punën e Bashkuar që janë në kundërshtim me Ligjin për Ndërmarrjet. Ligji për Ndërmarrjet, sidoqoftë, nuk u jep ndonjë përgjigje çështjeve që trajtohen me nenin 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar. Për këtë arsye, neni 608 i Ligjit për Punën e Bashkuar në asnjë mënyrë nuk është në kundërshtim me Ligjin për Ndërmarrjet.

Rregullorja e UNMIK-ut 1999/24 parasheh se ligjet që janë miratuar nga Kuvendi i Jugosllavisë/Serbisë pas datës 22.3.1989 nuk janë ligje në fuqi në Kosovë. Gjykata konstaton se Ligji për ndryshimin e Ligjit për Ndërmarrjet dhe Ligji për Marrëdhëniet Themelore të Punës nuk janë ligje në fuqi, pasi që ato kanë hyrë në fuqi pas datës 22.03.1989.

Tutje shkalla e parë ka konstatuar se nuk ishte kontestuese se paditësit me 24 shkurt 2005, i ishte ndërprerë kontrata e punës për shkak të privatizimit të NSH-së. Po ashtu duke u bazuar në deklaratat e pakontestueshme të dyja palëve, gjeti periudhën e saktë 16 vjeçare punë për NSH, për të cilën periudhë kohore nga 23 maj 1988 deri 24 shkurt 2005, paditësit i takojnë 3 paga mujore.

Neni 12.2 i Rregullores së UNMIK- ut 2001/ 27 thotë që: "Në rastet e largimit të shkallës së gjerë nga puna zbatohen dispozitat e mëposhtme: *(dh)punonjësi nuk mund të largohet nga puna derisa punëdhënësi të mos ia ketë paguar atij një dëmshpërblim të njëkohshëm. Dëmshpërblimi duhet t'i paguhet punonjësit në datën e shkëputjes së kontratës së punës sipas shkallës së mëposhtme:(i) prej 2 deri në 4 vjet stazh 1 pagë mujore(ii) prej 5 deri në 9 vjet stazh 2 paga mujore; (iii) prej 10 deri në 19 vjet stazh 3 paga mujore;(iv) prej 20 deri në 29 vjet stazh 4 paga mujore;(v) 30 vjet stazh e më tepër 5 paga mujore;*

Prandaj, në bazë të nenit 12.1 dhe nenit 12.2.1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/27 mbi Ligjin Themelor të Punës në Kosovë, ankuesi ka pasur të drejtë në pagesën e dëmshpërblimit për 3 muaj të pagës, e gjithherë duke u bazuar në listën e pagave të papaguara për muajin janar 2004 , që ishte shuma prej 162.00 Euro (  $162 \times 3 = 486.00 \text{€}$ ) e të cilat e paditura do t'i paguan në bazë të prioritetit të kërkesave të përcaktuara me nenin 40 nga Shtojca e Ligjit të AKP-së.

Me 15 shkurt 2023, AKP-ja e dorëzon një ankesë kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS C-IV-13-0850 të datës 24 janar 2023, dhe kërkon nga Kolegji i Apelit që të aprovohet ankesa e saj si e bazuar, të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar duke refuzuar ankesën ndaj vendimit PRN029-0243, të datës 01 shkurt 2023 si të bazuar dhe ta vërtetoj Vendimin e Autoritetit të Likuidimit. E paditura ka shtuar se një gjetje e tillë e Gjykatës është tërësisht jashtë kontestit faktik të çështjes. Autoriteti i Likuidimit ka vërejtura se Gjykata gjatë shqyrtimit të çështjes ka ngatërruar fakte të rëndësishme sa i përket arsyes së refuzimit të kërkesës së parashtruesit. Autoriteti i Likuidimit konsideron se arsyetimi i Gjykatës është në mospërputhje me arsyeshmërinë logjike dhe besueshmërinë ligjore me Vendimin e AL-së. Autoriteti i likuidimit thekson se Shtojca e ligjit të AKP-së ( Ligji Nr.04/L034), Neni 40.1.6.2 parashikon që punëtorëve u takon e drejta e dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës nëse "Jeni pushuar nga puna si rrjedhojë e apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga Agjencia Kosovare e Privatizimit sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit të AKP-së.

Tutje ka shtuar se Lista e pagave për 12 muajt e fundit para datës së privatizimit, e paraqitur nga menaxhmenti i NSH-së, nuk pasqyron ndonjë pagesë të kryer ndaj parashtruesit të kërkesës. Ky Autoritet i Likuidimit vëren se parashtruesi i kërkesës nuk ishte punëtor aktiv i NSH-së. Parashtruesi i kërkesës nuk duket të jetë pushuar nga puna si pasojë e një veprimi të ndërmarrë nga Agjencia siç parashikohet nga neni 6.1 apo 6.2 i Ligjit për AKP-në. Prandaj autoriteti i Likuidimit me të drejtë ka vlerësuar faktin se parashtruesit të kërkesës nuk i takon e drejta për përfitim nga dëmshpërblimet për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, e rrjedhimisht kërkesa është refuzuar si e pa vlefshme.

Autoriteti i Likuidimit rithekson edhe një herë se parashtruesi nuk saktëson se cili Nen i ligjit 04/L-034 është shkelur nga ana e Autoritetit të Likuidimit duke shkelur Nenin 70.2 i Shtojcës së Ligjit 04/L-033 i cili parashikon se Ankesa "duhet të bazohet në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në pajtim me Ligjin 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Kështu duke marrë parasysh mos respektimin e nenit 70.2 të Ligjit 04/L-033, Ankesa duhet të refuzohet si e pa bazuar.

Me 12 mars 2023, paditësi ka parashtruar përgjigje ndaj ankesës së AKP-së me të cilën ka propozuar që ankesa e të paditurës në tersi të refuzohet si e pa bazë

dhe të vërtetohet Aktgjykimi i atakuar. Tutje paditësi ka theksuar se shkalla e I-rë e DHPGJSK-së me aktgjykimin e ankimuar, në këtë çështje ka vendosur në mënyrë të drejtë dhe ligjore, kështu që në aktgjykimin e ankimuar nuk qëndrojnë bazat ankimore të ushtruara nga i padituri.

### **Arsyetimi ligjor:**

Ankesa e te paditurës, AKP-së refuzohet si e pa bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP) Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

### **Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit**

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë i DHPGJS-së është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj duhet të vërtetohet.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi me 21 dhjetor 2010 ka parashtruar kërkesë tek Autoriteti i Likuidimit me të cilën ai ka kërkuar kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, por që AL me Vendimin PRZ029-0243, të datës 30 maj 2013, kërkesën e kishte refuzuar me arsyetimin që parashtruesit nuk i takon kjo e drejte pasi që i njëjti ai nuk figuronte në listën e pagave për 12 muajt e fundit dhe se nuk i takon kompensimi sipas nenit 40.1.6.2 të Ligjit për AKP.

Shkalla e I-rë e DHPGJS-së kishte marrë Aktgjykimin C-IV-13-0850, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar ankesën e paditësit dhe ka obliguar të paditurën AKP ti paguaj paditësit në emër të dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës, shumën prej 486.00 € ndërsa, pjesa tjetër e kërkesës përtej shumës së aprovuar është refuzuar si e pa bazuar.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi me ankesën e tij të dorëzuar në Shkallën e I-rë ka bashkangjitur: kopjen e Librezës së punës, njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës pranë NSH "NGLB Kosova "Prizren, të lëshuar nga AKM.

Kolegji i Apelit konsideron se shkalla e parë me të drejtë ka konstatuar se paditësi kishte një marrëdhënie pune në NSH gjatë periudhës 23 maj 1988 deri më 24 shkurt 2005 dhe po ashtu është i saktë konstatimi se si rezultat i privatizimit të NSH- së me 24 shkurt 2005, paditësit i ishte ndërprerë marrëdhënia e punës dhe se i ishte bërë me dije që shumat pagat që i janë mbetur borgj do të mbesin përgjegjësi e punëdhënësit, të cilat do të shqyrtohen sipas procedurave të likuidimit.

Kolegji i Apelit vlerëson se Shkalla e parë ka zbatuara drejtë dispozita ligjor që ishin në fuqi respektivisht nenin Neni 12.2 i Rregullores së UNMIK- ut 2001/ 27 thotë që: *"Në rastet e largimit të shkallës së gjerë nga puna zbatohen dispozitat e mëposhtme: (dh)punonjësi nuk mund të largohet nga puna derisa punëdhënësi të mos ia ketë paguar atij një dëmshpërblim të njëkohshëm. Dëmshpërblimi duhet t'i paguhet punonjësit në datën e shkëputjes së kontratës së punës sipas shkallës së mëposhtme:(i) prej 2 deri në 4 vjet stazh 1 pagë mujore(ii) prej 5 deri në 9 vjet stazh 2 paga mujore;*  
*(iii) prej 10 deri në 19 vjet stazh 3 paga mujore;(iv) prej 20 deri në 29 vjet stazh 4 paga mujore;(v) 30 vjet stazh e më tepër 5 paga mujore;*

Kolegji i Apelit vlerëson se paditësi ka pasur të drejtë në pagesën e dëmshpërblimit për 3 muaj të pagës, duke u bazuar në listën e pagave të papaguara për muajin janar 2004 , që ishte shuma prej 162.00 Euro ( 162x3=486.00€) e të cilat e paditura do t'i paguan në bazë të prioritetit të kërkesave të përcaktuara me nenin 40 nga Shtojca e Ligjit të AKP-së.

Kolegji i Apelit konstaton se paditësi me provat e dorëzuara siç ishin libreza e punës dhe njoftimi për ndërprerjen e marrëdhënies se punës ka arritur ta dëshmojë, se ai ishte punëtor i NSH gjer më datën e fillimit të privatizimit, dhe se marrëdhënia e punës i është ndërprerë me veprimin e Agjencisë, andaj pretendimit e të paditurës se ai nuk ishte në listën e pagave në kohën e privatizimit të NSH-së, janë të pabazuara dhe të pa mbështetura në prova.

Andaj nga këto arsye, ankesa e AKP-së refuzohet si e pa bazuar, dhe vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Nga se u tha më sipër në bazë të nenit 9.10 të LDHP është vendosur si në dispozitiv.

### **Taksat gjyqësore**

Ankuesja tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 23 gusht 2024.

Mr.Sc Sahit Sylejmani, Gjyqtar kryesues

\_\_\_\_\_